



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



N.T.P. "Zico. TV"  
Nr. i biznesit - 70429555  
Pronar –Rafete MEMINI  
OSHMA ZICO TV  
Rr/Gjinollët Nr.46  
Gjilan

"Zico TV" SH.P.K.  
Nr. i biznesit - 810057853  
Pronar: Nexhmedin ISMAILI  
Rr/Gjinollët Nr.46  
Gjilan

Ref: 1711/1302/LIC/ni

### VENDIM

për ndryshimin e pronësisë së OSHMA Zico TV dhe bartjen e licences nga N.T.P. "Zico. TV"  
në "Zico TV" SH.P.K.

#### Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Medive (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Zico TV është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audiovizuale, i cili është i licencuar për transmetimin e programeve televizive përmes operatorëve të shpërndarjes Zico TV, është pajisur me licencë të KPM-së me datën 5 dhjetor 2008.
3. Më datën 18 tetorë 2017, pronarja e OSHMA Zico TV znj. Rafete MEMINI, ka parashtruar një kërkesë, me anë të së cilës ka kërkuar miratimin e KPM-së, për ndryshimin e pronësisë dhe bartjen e licences nga N.T.P. "Zico. TV" në "Zico TV" SH.P.K, me pronar z. Nexhmedin ISMAILI.

#### Arsyetimi

4. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit të KPM-së përcakton se: "*për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja*".
5. Neni 21, paragrafi 3 i Ligjit të KPM-së përcakton se: "*licencat nuk mundë të shfrytëzohen dhe bartën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim të KPM-së*".

6. Neni 15. pika 2. Paragrafi 1 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“Për çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 10% të aksioneve të interesave ose ato që kanë ndikim të theksuar në kontrollin e të Licencuarit, kërkohet paraprakisht aprovimi me shkrim nga ana e KPM-së”*
7. Neni 15.4 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“KPM-ja do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur sigurohet që personi fizik apo juridik, për të cilin propozohet që t’i transferohet licenca, i plotëson standardet e KPM-së për t’iu dhënë një licencë.”*
8. Komisioni konstaton se parashtruesi i kërkesës ka kryer të gjitha obligimet lidhur me tarifën vjetore të licencës së KPM-së dhe gjithashtu, ka bërë edhe pagesën e tarifës administrative në vlerë prej 100.00 (njëqind) eurove, për ndryshime në licencë.
9. Komisioni konsideron se, kërkesa e parashtruar për ndryshimin e pronësisë së Ofruesit të Shërbimit Medial Audiovizual është e kompletuar në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së, dhe si e tillë i përmbushë kushtet për miratim.

### Vendim

10. Komisioni, në takimin e mbajtur më datën 22 nëntor 2017, merr vendim për ndryshimin e pronësisë së OSHMA Zico TV dhe bartjen e licences nga N.T.P. "Zico. TV" tek "Zico TV" SH.P.K, me pronar z. Nexhmedin ISMAILI, si dhe licenca të ndryshohet.

### Lëshimi i Vendimit

11. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.

Adnan MEROVCI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



24.11.2017

datë